

“Plani mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore” të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes për vitin akademik 2017-2018.

Departamenti i Edukimit ne lidhje me relacionin mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore për vitin akademik 2017-2018 paraqet informacionin si më poshtë vijon .

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

1. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore do të organizoj edhe për këtë vit akademik Konferencën e 4-të Ndërkombëtare, **“Problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt standardeve të Bashkimit Europian”**, e cila do të mbahet më **20 dhjetor 2017..**
2. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është dhe konferenca studentore e cila mbahet çdo vit nga studentët e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Departamenti ka planifikuar edhe për këtë vit akademik konferencën studentore me temë **“Sfidat e mësimdhënies me kompetenca në arsimin parauniversitar”**.
1. **Organizimi i leksioneve të hapura** është kthyer në një traditë të për departamentin tonë. Edhe këtë vit akademik ashtu si çdo vit tjetër departamenti do të organizoj leksione të hapura duke ftuar në auditorët tona personalitete të shquara në fushën e edukimit, ekspertë të arsimit dhe fushës së kurrikulave etj. Në orët e hapura kemi parashikuar të ftojme ekspertë të fushës së Edukimit, për të folur mbi zhvillimet e reja në arsim, mësimin me kompetenca, metodikat e mësimdhënies etj. Emrat që parashikohen të jenë pjesëmarrës në orët e hapura, do të jenë: Dr. Mirela Andoni, eksperte në fushën e arsimit Drejtuese e Sektorit të Trajnimit në IZHA, Prof. Petraq Simo Zv.Dekan i FSHS, Prof. Adem Tamo. Orët e hapura do të zhvillohen në semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018, me pjesëmarrjen studentëve të ciklit të parë BCH dhe ciklit të dytë Master.
2. Gjithashtu po bëhen përpjekje për organizimin e një workshop-i me temë: **“Multikulturalizmi dhe zbatimi i tij në sistemin arsimor shqiptar”**. Kjo veprimtari parashikohet të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit akademik me qëllim tërheqjen e studentëve në këtë aktivitet.
3. Në muajin tetor përkatësisht **në data 17, 18 tetor 2017**, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë

organizoi trajnimin e pedagogëve të “Albanian University” në fushën e metodologjisë, të mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe zbatimit të ligjit të ri për arsimin e lartë. Në kuadër të ditëve të programuara për trajnim, Prof.as. Dr. Qazim Dushku, referoi në lidhje me “Metodat e mësimdhënies në arsimin e lartë” (trajnim i mbajtur në datën 17 tetor 2017), ndërsa Porof. Dr. Nikoleta Mita, referoi temën “Kurrikula e re në Arsimin e Lartë”. Ndërkaq Departamenti Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë, do të organizoj trajnimin e tretë me temë “Edukimi në vazhdim”, **në muajin dhjetor 2017**

Drejtuesi i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes

Dr. Ndiriçim Mehmeti